

MAPL konfirmon ligjshmërinë e plotë të vendimeve të seancës së tretë të Kuvendit Komunal

.....

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka konfirmuar se të gjitha vendimet e seancës së tretë të Kuvendit Komunal të Gjilanit, të mbajtur më 30 maj 2015, janë të ligjshme. Bëhet fjalë për shtatë vendime dhe një rregullore. MAPL ka shqyrtuar vendimet e Kuvendit Komunal të Gjilanit, duke vepruar sipas kompetencave dhe përgjegjësi ligjore që ka.

Konfirmimi i MAPL ka të bëjë me vendimet:

1. Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private, për nevoja të rrugës publike të deponisë së mbeturinave në Velekincë
2. Për themelimin e Komitetit konsultativ të ekspertëve të planifikimit hapësinor
3. Për planin e punës së Kuvendit Komunal për vitin 2015
4. Për planin e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2015
5. Për raportin financiar janar-mars 2015
6. Për Rregulloren për mbrotjtjen e të miturve nga dukuritë që dështojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre
7. Për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për transparencë komunale
8. Për lejimin e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale për nevoja të Bashkësisë Islame në lagjen “Zabeli i Sahit Agës”.

